

**KONTRATE  
SHITJE KUOTASH**

Në Tiranë, sot në datën 25/11/2021 (dymijë e njëzetë e një):

**Z. Kostandin Angjellari**, shtetas shqiptar, i lindur ne Leskovik, dtl 20.05.1994, dhe banues ne Tirane, Shtetas Shiptare, identifikuar me numer personal J40520081I,; referuar më poshtë si "Shitësi";

**Z. Rushan Xhaja**, shtetas shqiptar, i lindur ne Çorovode, dtl 19.06.1994, dhe banues ne Tirane, Shtetas Shiptare, identifikuar me numer personal J40619063I,; referuar më poshtë si "Shitësi";

dhe

**Z. Naidi Shuli**, shtetas shqiptar, i lindur ne Durres, dtl 27.03.1995, dhe banues ne Durres, shtetas shqiptare identifikuar me numer personal J555327067N ; referuar më poshtë si "Blerësi".

**Z. Redi Muharremi**, shtetas shqiptar, i lindur ne Durres, dtl 08.03.1997 dhe banues ne Durres, Shtetas Shqiptare, identifikuar me numer personal J70308076B; referuar më poshtë si "Blerësi".

**MEQËNËSE ekzistojnë faktet:**

**Z. Kostandin Angjellari**, është ortak i shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) M12018017J, dhe zotëron 25% të kuotave të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK,

**Z. Rushan Xhaja**, është ortak i shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK, shoqëri tregtare e të drejtës shqiptare, me NIPT(NUIS) M12018017J, dhe zotëron 25% të kuotave të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK,

**Z. Kostandin Angjellari**, dëshiron ti shesë 25% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të, **Z. Naidi Shuli**,

**Z. Rushan Xhaja**, dëshiron ti shesë 1 % të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Naidi Shuli**,

**Z. Rushan Xhaja**, dëshiron ti shesë 24 % të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Redi Muharremi**, sipas kushteve të mëposhtme:


**Z. Naidi Shuli** dëshiron të blejë nga **Z. Rushan Xhaja** 1% të kuotave totale të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK;

**Z. Naidi Shuli** dëshiron të blejë nga **Z. Kostandin Angjellari** 25% të kuotave totale të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK;

**Z. Redi Muharremi** dëshiron të blejë nga **Z. Rushan Xhaja** 24% të kuotave totale të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK;

Nisur sa më sipër, palët, me vullnet të lirë dhe të plotë, hartojn këte "Kontratë shitje kuotash", me përmbajtjen si më poshtë :

hartojn këte "Kontratë shitje



ASKII  
TECHNOLOGIES 1  
M12018017J  
TIRANË

### Neni 1

#### Qëllimi i kontratës

- Qëllimi i kësaj kontrate është transferimi i 50 % të kontributeve totale të shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK, nga shitësit, tek blerësit.
- Kjo kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrës së transferimit të pronësisë dhe pagesës përkatëse lidhur me këtë transferim në përputhje me legjislacionin përkatës.

### Neni 2

#### Objekti i kontratës

-Nëpërmjet kësaj kontrate, shitësit transferon në favor të blerësve 50% të kontributeve totale të shoqërisë si më poshtë të përcaktuara:

- **Z. Kostandin Angjellari**, dëshiron ti shesë 25% të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të, **Z. Naidi Shuli**,
- **Z. Rushan Xhaja**, dëshiron ti shesë 1 % të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Naidi Shuli**,
- **Z. Rushan Xhaja**, dëshiron ti shesë 24 % të kontributeve totale të shoqërisë, ortakut të ri, **Z. Redi Muharremi**,

### Neni 3

#### Çmimi dhe menyra e pagimit

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes të kontributeve që shitësi transferon në favor të blerësit do të jetë në vlerën nominale të kuotave, konkretisht:

- **Z. Naidi Shuli** i ka paguar **Z. Kostandin Angjellari**, **25.000** lek për kuotën që përfaqëson **25 %** të kapitalit të shoqërisë;
- **Z. Naidi Shuli** i ka paguar **Z. Rushan Xhaja**, **1.000** lek për kuotën që përfaqëson **1 %** të kapitalit të shoqërisë;
- **Z. Redi Muharremi** i ka paguar **Z. Rushan Xhaja**, **24.000** lek për kuotën që përfaqëson **24 %** të kapitalit të shoqërisë;

-Po ashtu, të dyja palët deklarojnë se shumatat e mësipërme i është shlyer përkatësisht **Z. Kostandin Angjellari** dhe **Z. Rushan Xhaja**, përpara nënshkrimit të kësaj kontrate, dhe se palët nuk kanë asnjë pretendim financiar kundrejt njëri-tjetrit.

### Neni 4

#### Përgjegjësitë dhe garancitë e palëve

Shitësit, nëpërmjet kësaj kontrate shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kontributeve që po transferohen me këtë kontratë shitje;
- b) se kontributet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër;
- c) se transferimi i këtyre kontributeve në drejtim të blerësve është bërë në pajtim të plotë me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutore;
- d) se shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;

NENI 5

ASKII  
TECHNOLOGIES  
M12018017J  
TIRANE

### Efektet e kontratës

-Kjo kontratë ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dy-palëshe.

-Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

### NENI 6

#### Informacioni konfidencial

-Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

### NENI 7

#### Transferimi i të drejtave

-Menjëherë mbas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësia pranë regjistrimit tregtar të QKB.

-Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK do t'i përkasë ortakëve, si më poshtë:

- **Z. Naidi Shuli, zotërues i kuotës, që përfaqëson 51 % të kapitalit të Shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK; në vlerë kapitali 51.000 LEKË (Pesedhjet e nje mij) lek.**
- **Z. Redi Muharremi, zotërues i kuotës, që përfaqëson 49 % të kapitalit të Shoqërisë "ASKII TECHNOLOGIES" SHPK; në vlerë kapitali 49.000 LEKË (Dyzet e nentemij) lek.**

### NENI 8

#### Ligji i aplikueshëm, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

-Kontrata është hartuar në përputhje me Legjislacionin tregtar në fuqi.

-Blerësi dhe shitësi angazhohen të bëjnë cdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konfliktet të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negociimeve të drejtëpërdrejta.

-Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do t'i nënshtrohet juridiksionit gjyqësor përkatës.

### NENI 9

#### Dispozita përfundimtare


-Kjo kontratë është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë, e cila ju lexua me zë të lartë e të qartë palëve

-Palët deklaruan se e dëgjuan, e kuptuan dhe meqënëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruan personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.


### PALËT KONTRAKTORE

#### SHITËSI

Z. Kostandin Angjellari




Z. Rushan Xhaja



ASKII  
TECHNOLOGIES  
M12018017J  
TIRANE

#### BLERËSI

Z. Naidi Shuli,



Z. Redi Muharremi

